

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Tetor 2025

21.11.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin tetor 2025.

Rritet numri i përfituesve të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

	Muaji/Viti		10/2025
	21/10/2024	21/10/2025	10/2024
Skema e ndihmës sociale	18,358	16,360	-10.9
Pensionet bazike të moshës	153,383	164,213	7.1
Pensionet kontributpaguese të moshës	48,252	47,442	-1.7
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	20,805	21,562	3.6
Pensionet e Trepçës	1,153	916	-20.6
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	854	922	8.0
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1,365	1,382	1.2
Skema e të verbërve	1,818	1,825	0.4
Pensionet Familjare	2,852	2,533	-11.2
Pensionet e Invalidëve të punës	41	30	-26.8
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	3,081	3,437	11.6
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	14,215	14,928	5.0
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	12,741	12,514	-1.8
Veteranët	36,929	37,094	0.4
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3,643	4,078	11.9

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin tetor 2025, krahasuar me muajin tetor 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-26,8%); skema për pensionet e Trepçës (-20,6%); skema për pensionet familjare (-11,2%); skema e ndihmës sociale (-10,9%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,8%); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-1,7%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin tetor 2025, krahasuar me muajin tetor 2024 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11,9%); skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (11,6%); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (8,0%); skema e pensioneve bazike të moshës (7,1%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,0%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (3,6%); skema e kompensimeve për personat e verbër (0,4%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (1,2%); skema për veteranët e luftës (0,4%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin Tetor 2025, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>